REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1896/9 *Prot.* *Tiranë, më* 31.07 *.2026*

VENDIM

NR. 83 **, DATË** 31.7 **.2026**

PËR MIRATIMIN E KRITEREVE TË PRANIMIT NË PROGRAMIN E CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE, DOKTORATË DHE TË DREJTIMEVE TË KËRKIMIT SHKENCOR, PËR VITIN AKADEMIK 2026-2027, NË FAKULTETIN E SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE, UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

Në zbatim të ligjit Nr. 80/2015, *"Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"*, neni 3 e në vijim; Vendimit nr.112, datë 23.02.2018 *"Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor"* të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar; Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, neni 5, neni 12, neni 88, neni 89; Rregullores së Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, neni 69, neni 70; Rregullores "*Për organizimin e programeve të Studimit të Doktoratave*", e përditësuar, dhe bazuar në propozimin e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, me shkresat nr. 568/2 prot., datë 24.06.2026 dhe nr. 568/4 prot., datë 09.07.2026, në mbledhjen e datës 31.07.2026, Senati Akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë,

VENDOSI:

1. Të miratojë kriteret e pranimit (të përgjithshme dhe preferenciale), si dhe drejtimet e kërkimit shkencor për programin e ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë në Shkenca Mjekësore Teknike" me nënfusha: "Teknologji Mjekësore Diagnostikuese dhe Trajtuese"; "Infermieri dhe Mami"; "Fizioterapi dhe Rehabilitim", sipas aneksit nr.1 bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë i përcillet Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike të UMT-së.

KRYETARI

Prof. Dr. Xheladin DRAÇINI

Aneksi nr. 1: Drejtimet e kërkimit shkencor dhe kriteret e pranimit në programin e ciklit të tretë të studimit Doktoratë me nënfusha, viti akademik 2026-2027, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, UMT.

1. Doktoratë në Shkenca Mjekësore Teknike me nënfusha:

1.1. Fizioterapi dhe Rehabilitim

Drejtimi i kërkimit shkencor:

1. Biomekanika Klinike dhe Kineziologjia e Zbatuar
2. Shkencat e Rehabilitimit të Avancuar dhe rehabilitimi Geriatrik
3. Pediatria Zhvillimore dhe Neurorehabilitimi i Hershëm
4. Terapitë rehabilituese Respiratore dhe Kardiopulmonare

Kriteret e përgjithshme:

1. Të ketë përfunduar studimet e larta në fushën e Fizioterapisë ose Logopedisë dhe të zotërojë diplomë Bachelor dhe Master i Shkencave në fushën e Fizioterapisë ose diplomë Bachelor dhe Master i Shkencave në fushën e Logopedisë ose një diplomë të barasvlefshme (Master i Shkencave) sipas sistemit të vjetër në fushën fizioterapisë ose logopedisë, ose të fituar jashtë vendit dhe të njohur nga organet kompetente;
2. Të zotërojë me dëshmi një prej 5 gjuhëve të huaja të BE-së të paktën në nivelin B2 (Anglisht, Gjermanisht, Spanjisht, Italisht, Frëngjisht), në përputhje me Udhëzimin përkatës të Ministrisë përgjegjëse për arsimin;
3. Të ketë notë mesatare të ponderuar të ciklit të parë dhe dytë mbi 8(tetë).
4. Të paraqesë projekt individual kërkimor-shkencor në përputhje me fushat/drejtimet kërkimore të përcaktuara nga Dekanati i FSHMT-së, pika 1.1, a) dhe të projekt propozimeve të udhëheqësve shkencorë përkatës të bëra publike.
5. Të dëshmojë nëpërmjet projekt idesë/planit individual kërkimor, njohuri dhe aftësi për:
   - Të menduarin krijues;
   - Sensin kritik të zhvillimit të fushës së kërkimit;
   - Lidhjet midis fushave të kërkimit;
   - Zgjidhjen e problemeve që dalin gjatë punës kërkimore;
   - Kompetencë në menaxhimin e kompleksitetit të kërkimit dhe ideve të reja.
6. Të ketë dy rekomandime për aplikim, me vlerësime pozitive nga persona që kanë titullin akademik "Profesor i Asociuar" ose "Profesor", të cilët njohin aftësitë akademike dhe profesionale të kandidatit;
7. Të mos jetë marrë masë disiplinore ndaj tij/saj, apo të mos jenë gjetur shkelje të rregullave të etikës së kërkimit shkencor, të të drejtave që burojnë nga pronësia intelektuale, apo shkelje të rregullave kundër plagjiaturës, si dhe shkelje të kodit deontologjik profesional;
8. Të vetëdeklarojë se është në gjendje të zbatojë standardet shkencore dhe etike;
9. Të mos jetë duke ndjekur një program tjetër studimi.

Kriteret preferenciale:

1. Preferohet të ketë eksperiencë në mësimdhënie ne fushën e fizioterapisë apo të logopedisë; me kohë të pjesshme në FSHMT.

2. Preferohet të ketë trajnime/specializime në fushën e fizioterapisë ose logopedisë;
3. Preferohet të ketë eksperiencë pune në fushën e fizioterapisë ose të logopedisë, klinike në profilin përkatës;
4. Preferohet të ketë marrë pjesë në aktivitete shkencore si dhe të ketë botime në revista të indeksuara në fushën e fizioterapisë ose logopedisë;
5. Projekte kombëtare apo ndërkombëtare në fushën e fizioterapisë apo të logopedisë.

1.2 Infermieri dhe Mami

Drejtimi i kërkimit shkencor:

1. Kujdesi Infermieror i Avancuar dhe Menaxhimi i Sëmundjeve Kronike
2. Kujdesi Infermieror Onkologjik dhe Paliativ i Avancuar
3. Patologjitë Kronike Degjenerative dhe kujdesi infermieror afatgjatë
4. Sëmundjet e shëndetit mendor
5. Shkencat Perinatale dhe Shëndeti Riprodhues

Kriteret e përgjithshme:

1. Të ketë përfunduar studimet e larta në fushën e Infermierisë ose Mami dhe të zotërojë diplomë Bachelor dhe Master i Shkencave në fushën e Infermierisë ose diplomë Bachelor dhe Master i Shkencave në fushën e Mamisë ose një diplomë të barasvlefshme (Master i Shkencave) sipas sistemit të vjetër në fushën Infermieri ose Mamisë, ose të fituar jashtë vendit dhe të njohur nga organet kompetente;
2. Të zotërojë me dëshmi një prej 5 gjuhëve të huaja të BE-së të paktën në nivelin B2 (Anglisht, Gjermanisht, Spanjisht, Italisht, Frëngjisht), në përputhje me Udhëzimin përkatës të Ministrisë përgjegjëse për arsimin;
3. Të ketë notë mesatare të ponderuar të ciklit të parë dhe të dytë mbi 8(tetë).
4. Të paraqesë projekt individual kërkimor-shkencor në përputhje me fushat/drejtimet kërkimore të përcaktuara nga Dekanati i FSHMT-së, pika 1.2, a) dhe të projekt propozimeve të udhëheqësve shkencorë përkatës të bëra publike.
5. Të dëshmojë nëpërmjet projekt idesë/planit individual kërkimor, njohuri dhe aftësi për:
   - Të menduarin krijues;
   - Sensin kritik të zhvillimit të fushës së kërkimit;
   - Lidhjet midis fushave të kërkimit;
   - Zgjidhjen e problemeve që dalin gjatë punës kërkimore;
   - Kompetencë në menaxhimin e kompleksitetit të kërkimit dhe ideve të reja.
6. Të ketë dy rekomandime për aplikim, me vlerësime pozitive nga persona që kanë titullin akademik "Profesor i Asociuar" ose "Profesor", të cilët njohin aftësitë akademike dhe profesionale të kandidatit;
7. Të mos jetë marrë masë disiplinore ndaj tij/saj, apo të mos jenë gjetur shkelje të rregullave të etikës së kërkimit shkencor, të të drejtave që burojnë nga pronësia intelektuale, apo shkelje të rregullave kundër plagjiaturës, si dhe shkelje të kodit deontologjik profesional;
8. Të vetëdeklarojë se është në gjendje të zbatojë standardet shkencore dhe etike;
9. Të mos jetë duke ndjekur një program tjetër studimi.

Kriteret preferenciale:

1. Preferohet të ketë eksperiencë në mësimdhënie ne fushën e infermierisë apo të mamisë; me kohë të pjesshme në FSHMT.

2. Preferohet të ketë trajnime/specializime në fushën e infermierisë ose mamisë;
3. Preferohet të ketë eksperiencë pune në fushën e infermierisë ose mamisë; klinike në profilin përkatës.
4. Preferohet të ketë marrë pjesë në aktivitete shkencore si dhe të ketë botime në revista të indeksuara në fushën e infermierisë ose mamisë;
5. Projekte kombëtare apo ndërkombëtare në fushën e Infermierisë apo të Mamisë.

1.3 Teknologji Mjekësore Diagnostikuese dhe Trajtuese

Drejtimi i kërkimit shkencor:

1. Imazheria e Avancuar Diagnostike (CT/MRI): Protokollet e Optimizimit dhe Radiomika
2. Radioterapia e Targetuar, Dozimetria e Avancuar dhe Siguria në Onkologji
3. Biomedicina Laboratorike, Diagnostika Molekulare dhe Saktësia Gjenomike
4. Imunologjia Translacionale dhe Imunodiagnostika e Avancuar

Kriteret e përgjithshme:

1. Të ketë përfunduar studimet e larta në fushën e teknikës së imazherisë ose laboratorit mjekësor dhe të zotërojë diplomë Bachelor dhe Master i Shkencave në teknikë imazherie ose diplomë Bachelor dhe Master i Shkencave në teknikë laboratori ose një diplomë të barasvlershme (Master i Shkencave) sipas sistemit të vjetër në fushën teknikë imazherie osë të laboratorit mjekësor, ose të fituar jashtë vendit dhe të njohur nga organet kompetente;
2. Të zotërojë me dëshmi një prej 5 gjuhëve të huaja të BE-së të paktën në nivelin B2 (Anglisht, Gjermanisht, Spanjisht, Italisht, Frëngjisht), në përputhje me Udhëzimin përkatës të Ministrisë përgjegjëse për arsimin;
3. Të ketë notë mesatare të ponderuar të ciklit të parë dhe të dytë mbi 8(tetë).
4. Të paraqesë projekt individual kërkimor-shkencor në përputhje me fushat/drejtimet kërkimore të përcaktuara nga Dekanati i FSHMT-së, pika 1.3, a) dhe të projekt propozimeve të udhëheqësve shkencorë përkatës të bëra publike.
5. Të dëshmojë nëpërmjet projekt idesë/planit individual kërkimor, njohuri dhe aftësi për:
   - Të menduarin krijues;
   - Sensin kritik të zhvillimit të fushës së kërkimit;
   - Lidhjet midis fushave të kërkimit;
   - Zgjidhjen e problemeve që dalin gjatë punës kërkimore;
   - Kompetencë në menaxhimin e kompleksitetit të kërkimit dhe ideve të reja.
6. Të ketë dy rekomandime për aplikim, me vlerësime pozitive nga persona që kanë titullin akademik "Profesor i Asociuar" ose "Profesor", të cilët njohin aftësitë akademike dhe profesionale të kandidatit;
7. Të mos jetë marrë masë disiplinore ndaj tij/saj, apo të mos jenë gjetur shkelje të rregullave të etikës së kërkimit shkencor, të të drejtave që burojnë nga pronësia intelektuale, apo shkelje të rregullave kundër plagjiaturës, si dhe shkelje të kodit deontologjik profesional;
8. Të vetëdeklarojë se është në gjendje të zbatojë standardet shkencore dhe etike;
9. Të mos jetë duke ndjekur një program tjetër studimi.

Kriteret preferenciale:

1. Preferohet të ketë eksperiencë në mësimdhënie në fushën e imazherisë apo të laboratorit mjekësor; me kohë të pjesshme në FSHMT.

2. Preferohet të ketë trajnime/specializime në fushën e imazherisë apo të laboratorit mjekësor;
3. Preferohet të ketë eksperiencë pune në fushën e imazherisë apo të laboratorit mjekësor;
4. Preferohet të ketë marrë pjesë në aktivitete shkencore si dhe të ketë botime në revista të indeksuara në fushën e imazherisë apo të laboratorit mjekësor;
5. Projekte kombëtare apo ndërkombëtare në fushën e imazherisë apo të laboratorit mjekësor.